



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet për trajnues-profesionet e lira

Prill 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Takimi me prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së X (dhjetë)



Më 24 prill 2023 është realizuar takimi i parë me 21 prokurorët e sapoemëruar të cilët për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e X në Programin e tëTrajnimit Fillestar.

Më 24 prill 2023 është realizuar takimi i parë me 21 prokurorët e sapoemëruar të cilët për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e X në Programin e Trajnimit Fillestar.

Të pranishëm në takim përveç Drejtorit Ekzekutiv të AD-së dhe Udhëheqëses së këtij programi ishin edhe Kryesuesi i KPK-së-së z Jetish Maloku.

Hapjen e këtij takimi e bëri Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu duke i uruar prokurorët e ri për emërimin e tyre dhe fillim të mbarë në rrugëtimin e detyrës së re për të vazhduar më pas me njoftimin e rolit dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për ngritjen e shkathtësive profesionale dhe praktike. Po ashtu z. Fejzullahu, në pika të shkurta elaboroi

strukturën e programit fillestar, mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij, si të pjesës teorike, po ashtu edhe atë praktike, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë program. Më tej ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të Akademisë së Drejtësisë, për mbështetje të vazhdueshme për prokurorët e sapoemëruar, me qëllim që trajnimi fillestar të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Prokurorëve të sapo emëruar iu drejtua edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, i cili potencoi mbështetjen e KPK-së në drejtim të prokurorëve të sapoemëruar. Vëmendje të veçantë i kushtoi rolit dhe rëndësisë që ka trajnimi fillestar në zhvillimin dhe aftësimin e tyre dhe në vazhdim i njoftoi edhe me sfidat të cilat do ti presin gjatë ushtrimit të detyrës.

Në përmbyllje të takimit njoftues, Udhëheqësja e Programit të Trajnimeve Fillestare znj. Valmira Pefqeli ofroi informata të detajuara rreth programit, mënyrës së realizimit të trajnimit teorik që ofrohet në AD dhe atij praktik i cili do të realizohet në prokuroritë përkatëse ku janë të emëruar. Po ashtu theksoji edhe procesin e vlerësimit gjatë trajnimit i cili ka rëndësi në performancën e prokurorëve në trajnimin fillestar.



Takimi me gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e dhjetë)



Me 24 prill 2023 ngjashëm si me prokurorët e sapo emëruar është realizuar takimi edhe me 29 gjyqtarët e sapo emëruar në 6 Gjykata Themelore të Republikës së Kosovës, të cilët po ashtu përbëjnë gjeneratën e X të gjyqtarëve në Programin e trajnimit Fillestar.

Të pranishëm në takim përveq Drejtorit Ekzekutiv të AD-së dhe Udhëheqëses së këtij programi ishin edhe Kryesuesi i KGJK-së z. Albert Zogaj, Kryetari i Gjykatës së Apelit z. Valon Totaj si dhe Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë znj. Albina Rama.

Në fjalën hyrëse z. Enver Fejzullahu, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, fillimisht i uroi gjyqtarët për emërimin e tyre dhe rrugëtimin në detyrën e re, për të vazhduar tutje me njoftimin e rolit dhe rëndësisë që ka trajnimi fillestar, për përgatitjen e tyre të mëtejme profesionale dhe avancimin e njohurive. Gjyqtarët e sapo emëruar u njoftuan rreth strukturës së trajnimit dhe metodologjisë së realizimit të trajnimit. z. Fejzullahu me theks të veçantë siguroj gjyqtarët për mbështetje të vazhdueshme gjatë rrugëtimin njëvjeçarë me qëllim që trajnimi fillestar të shërbej në ngritjen profesionale dhe zhvillimin e shkathtësive.



Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Albert Zogaj në fjalën e tij mes tjerash uroi gjyqtarët për pozitën e re duke ju dëshiruar punë të suksesshme ndërkaq theksoi edhe sfidat që do i presin. Po ashtu z. Zogaj shprehu mbështetjen dhe bashkëpunimin në mes të KGJK-së dhe AD-së duke i inkurajuar gjyqtarët e sapo emëruar për një përkushtim dhe angazhim maksimal me qëllim të përgatitjes së tyre adekuate që të ushtrojnë në mënyrë të drejtë dhe profesionale funksionin e gjyqtarit.

Gjyqtarëve të sapo emëruara me një fjalë rasti ju drejtua edhe znj. Albina Shabani, Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe z. Valon Totaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit përmes të cilave gjyqtarëve ju uruan detyrën e re dhe sukseset në punë.

Së fundmi gjyqtarëve të sapo emëruar, iu drejtua edhe Udhëheqësja e Programit të Trajnimeve Fillestare znj. Valmira Pefqeli e cila ofroi informata të detajuara rreth programit trajnues, mënyrës së realizimit të trajnimit teorik dhe praktik. Po ashtu theksoji edhe rëndësinë e vlerësimit gjatë trajnimit i cili ka impakt në performancën e gjyqtarëve.

Gjyqtarët e sapoemëruar, janë pajisur me materialet e nevojshme që hynë në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar si dhe Kalendari trajnues për muajin prill dhe maj 2023.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023



Gjatë muajit prill, për 5 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 14 sesione të trajnimit teorik dhe 9 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe nga moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga moduli Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli “Ushtrimi i mjeteve juridike” me ç’rast janë trajtuar: përpilimi i ankesës nga prokurori i shtetit kundër aktgjyqimit për shkak të shkeljeve esenciale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal si dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike dhe ushtrimi i mjeteve juridike.

Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion nga nën moduli “Procedurat e veçanta sipas KPPK” përkatësisht në rrethanat që gjyqtari i vetëm gjykues nuk detyrohet nga kërkesa për urdhër ndëshkimorë.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli: “Krimi kibernetik” me ç’rast janë trajtuar aspekte të rëndësishme si shoqëria e informacionit dhe krimi kibernetik, teknologjia, paisjet digjitale dhe provat elektronike.

Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion nga nën moduli “Udhëzuesi për politikën ndëshkimore” në kuadër të cilit janë trajtuar aspekte të rëndësishme të matjes së dënimit që Gjykata Supreme përmes këtij udhëzuesi ka synuar ndëshkueshmërinë në mënyrë të barabartë nga gjykatat e vendit.

Nga moduli: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën moduli: “Bashkëpunimi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” të cilat kanë përfshirë çështje të ndryshme ligjore nga bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje civile dhe penale.

Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion nga nën moduli: “KEDNJ” me ç’rast fokusi ishte te neni 2 i kësaj konvente.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Trajnimi praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023

Gjatë muajit prill, 45 gjyqtarët e gjeneratës së IX kanë vijuar sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar.

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar gjithsej 16 ditë trajnimi praktik, pjesë kjo e trajnimit e cila është realizuar nën mbikëqyrjen e gjyqtarit/mentor.

Në kuadër të këtij trajnimi, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës

gjatë muajit prill duke ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatëse me rastin e praktikës.

Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin Trajnues.

Gjithashtu vijueshmëria e tyre në trajnimin praktik gjatë muajit ka qenë e rregullt dhe me këtë është përmbush trajnimi praktik sipas kalendarit trajnues.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023-2024



Bazuar në legjislacionin në fuqi, pas dekretimit të 29 gjyqtarëve të rinj (1 prej tyre nga komuniteti boshnjak), Akademia e Drejtësisë, me datë 24 prill 2023, ka filluar zyrtarisht trajnimin fillestar për këta gjyqtarë që sipas radhës përbëjnë gjeneratën e X të gjyqtarëve në PTF.

Me kërkesën e KGJK-së, trajnimi fillestar për gjyqtarë është filluar së zbatuari intenzivisht 5 ditë të javës me sesionet e trajnimit teorik deri në përfundim të gjitha moduleve trajnuese. Më pas me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse për 12 muaj deri në përmbushje të aktiviteteve sipas kalendarit trajnues.

Gjyqtarët e kësaj gjenerate kanë filluar me modulet: Rendi Juridik Kombëtarë dhe ndërkombëtare si dhe Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale. me ç’rast janë realizuar vetëm 8 sesione të trajnimit teorik me që trajnimi filloj

javën e fundit të muajit prill.

Në kuadër të Modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar janë realizuar 2 sesione sesione trajnuese nga nën moduli: “Drejtësia Kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial” me ç’rast janë trajtuar: burimet e së drejtës Kushtetuese dhe Roli i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Nga Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale, 2 sesione trajnuese ishin nga nën moduli: “Rregullat e komunikimit” me ç’rast janë trajtuar rregullat e brendshme të komunikimit dhe bazat e komunikimit.

Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 4 sesione trajnuese nga nën moduli “Etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore” me ç’rast janë trajtuar: Kodi i etikës profesionale për gjyqtarë, parimet e Kodit të Etikës, përgjegjësia shkeljet dhe masat ndaj gjyqtarëve dhe procedura disiplinore për gjyqtarët

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët e sapo emëruar patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe njëherësh diskutime interaktive për çështjet ligjore që u trajtuan.



Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024

Bazuar në legjislacionin në fuqi, pas dekretimit të 21 prokurorëve të rinj, paralelisht me gjyqtarët fillestar, Akademia e Drejtësisë me 24 prill 2023 ka filluar zyrtarisht trajnimin fillestar për këta prokurorë që sipas radhës përbëjnë gjeneratën e X të prokurorëve në PTF.

Programi i Trajnimit Fillestar për prokurorë ka filluar së zbatuari paralelisht me 2 (dy) ditë të trajnimit teorik nga modulet e këtij programi në Akademi të Drejtësisë dhe 3 (tre) ditë tjera të javës trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit.

Meqenëse është filluar në fund të muajit prill, gjatë kësaj periudhë janë realizuar vetëm dy sesione të trajnimit teorik. Këto sesione ishin 1 nga moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar dhe 1 nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale.

Në kuadër të Modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, sesioni trajnues ishte nga nën

moduli: “Drejtësia Kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial” me ç’rast janë trajtuar: burimet e së drejtës Kushtetuese dhe Roli i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Nga Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale, sesioni trajnues ishte nga nën moduli: “Rregullat e komunikimit” me ç’rast janë trajtuar rregullat e brendshme të komunikimit.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët e sapo emëruar patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe njëherësh diskutime interaktive për çështjet ligjore që u trajtuan.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar i trajnimit- Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare-Sesioni I

Më 04-06 Prill 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me elementet e veprës penale të korrupsionit për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore me rastin e hetimit dhe gjykimit të veprave përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në shpjegimet e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare me fokus te dashja si element i veprës penale, çështjet e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit, qëllimit si element për vërtetimin e veprës penale të korrupsionit, vlerësimit të provave bindëse, të drejtpërdrejta dhe rrethore, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethore, mashtrimin në prokurim si vepër e ndërlikuar, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në prezantimin e sistemit ligjor te ShBA-së, dhe me

raste praktike në luftimin e korrupsionit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vlerësimit të provave në veprimet e policisë dhe masat e fshehta qoftë të drejtpërdrejta dhe rrethore, krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethore si dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar si dhe pasojave të rrezikshmërisë së këtyre veprave.

Pas përfundimit për secilën nga këto çështje u ofruan raste nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë duke krahasuar dhe shkëmbyer përvojat dhe praktikatat të cilat ishin të dobishme për secilin nga pjesëmarrësit që vendosin lëndët përkatëse.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 17 gjyqtarë kryesisht nga niveli themelor i gjykatave, 22 prokurorë (8 nga niveli themelor i prokurorive, 1 nga Apeli dhe 13 nga PRSK) si dhe 6 zyrtarë policor.



Trajnim: Sigurimi i kërkesë padisë

Më 04 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Sigurimi i kërkesëpadisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për sigurimin e kërkesë padisë në rastet pranë gjykatave për mbrojtjen e të drejtave të palëve deri sa merret vendimi përfundimtarë mbi meritat e padisë.

Diskutimi në këtë trajnim është fokusuar në identifikimin e kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, garancionit si kusht për caktimin e masës së sigurimit, identifikimin e llojit të masave të sigurimit, të kuptuarit për efektin e masave të sigurimit, kohëzgjatjen e

tyre dhe shpërblimi i shpenzimeve të shkaktuara rreth zbatimit të masave të sigurimit të kërkesëpadisë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve nga praktika gjyqësore veçanërisht te kontestet pronësore, kontestet sipas padisë për borxhe si dhe kontestet familjare në të cilat më së shpeshti caktohet masa e sigurisë. Përmes diskutimit të këtyre rasteve pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit dhe përvetësimit të praktikave më të mira të sigurimit të kërkesë padisë.

Përfitues të këtij trajnimi 25 gjyqtarë nga niveli themelor i gjykatave dhe nga Gjykata Komerciale.



Trajnim: Qasje multi institucionale ndaj Dhunës gjinore me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve

Më 4 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Gjakovës

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Gjakovës për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave

të njeriut. Më tej u diskutua edhe për shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i pësojnë dhe shpesh edhe humbje të parevokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 1 prokuror, 1 avokatë, 1 mbrojtës i viktimave, 4 zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale, 2 avokatë si dhe 6 zyrtarë policor.



Trajnim: E drejta në privatësi dhe e drejta në jetë familjare, -neni 8 i KEDNJ-së



Më 05 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “E drejta në privatësi dhe e drejta në jetë familjare - Neni 8 KEDNJ-së”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e standardeve dhe kërkesave nga neni 8-të i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe për praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) lidhur me të drejtën e jetës private dhe familjare.

Fokusi i trajnimit ishte në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban Neni 8 i KEDNJ për të drejtën në respektimin e jetës private dhe familjare si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Në vazhdim u potencua se E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare është një drejtë e parashikuar dhe e garantuar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në neni 36 të saj.

Në trajnim u trajtuan dilemat dhe çështjet që kanë të bëjnë me aspektet e dispozitave që përmbajnë këto nene duke sqaruar dilemat rreth interpretimit të dispozitave në fjalë përmes rasteve praktike të GJEDNJ. Veçmas u trajtuan nocionet themelore që përmban neni 8 i KEDNJ, si natyra juridike e jetës private dhe të jetës familjare, dhe kriteret e KEDNJ lidhur me privatësinë, korrespondencën dhe vendbanimin,

përgjimin si dhe mbledhjen e të dhënave. Gjithashtu në fokus ishte edhe zbatimi i drejtë dispozitave të këtij neni lidhur me ndërhyrjen e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejte, në shkallën e parashikuar me ligj. Në trajnim u trajtua edhe hezitimi në zbatimin e dispozitave të KEDNJ nga gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës.

Pas diskutimeve përmbajtjesore u konkludua se për t'u thirrur në nenin 8, ankesa duhet të hyjë në njërin prej katër dimensioneve, të garantuara nga dispozita, gjegjësisht në dimensionin e jetës private, të jetës familjare, të shtëpisë dhe të korrespondencës. Domethënia e katër koncepteve nuk është vetë-shpjeguese dhe është shumë e ndjeshme ndaj fakteve. Përveç kësaj, këto fusha nuk janë përjashtuese njëra me tjetrën, dhe një masë mund të ndërhyjë njëkohësisht në sfera të shumta.

Gjithashtu u veçua konkludimi se Gjykata iu ka shmangur përcaktimit të rregullave specifike lidhur me interpretimin e fushave të ndryshme të dimensioneve dhe zakonisht zhvillon procedurën sipas rastit apo lëndës së caktuar, duke ua dhënë koncepteve një domethënie autonome. Fleksibiliteti i Gjykatës mundëson marrjen parasysh të zhvillimeve shoqërore, ligjore dhe teknologjike, edhe pse nganjëherë profesionistëve të lëmit ua bën të vështirë përkufizimin e saktë të përmbajtjes së tyre. Analiza e praktikës gjyqësore dhe e rrethanave të caktuara të rasteve jep udhëzime të mjaftueshme për interpretimin e situatave nga këndvështrimi i nenit 8, duke pasur parasysh karakterin e tij ndryshues dhe dinamik.

Në trajnim u potencua se koncepti i jetës së familjes është zhvilluar në mënyrë të ngadaltë gjatë jetëgjatësisë së Konventës dhe vazhdon të zhvillohet duke marrë parasysh ndryshimet sociale dhe ligjore.

Gjykata, ashtu si për konceptin e jetës private, mban të njëjtin qëndrim të ekuilibruar në interpretimin e jetës së familjes duke pasur parasysh diversitetin e problemeve të familjes moderne, çështjet e divorcit dhe përparimet në mjekësi.

Në bazë të renditjes së fjalëve në këtë nen jeta familjare është pozicionuar direkt në përkatësinë e sferës private ku ka të drejtën për të vepruar pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit.

Ndër metodat kryesore që u përdoren në këtë trajnim ishin: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore; diskutime interaktive në grupe të ndara, të cilët mbrojtën dhe argumentuan qëndrime të ndryshme dhe

analizë të rasteve hipotetike dhe raste gjyqësore nga GJEDNJ, tw shoqëruara me diskutime interaktive, analizë të rasteve studimore, si dhe duke interpretuar dispozitat e nenit 8 te KEDNJ dhe nenit 36 të Kushtetutës së Kosovës.

Përfitues në këtë trajnim ishin 5 gjyqtarë të cilët ishin nga radhët e Gjykatës së Apelit dhe nivelit themelor të gjykatave (2 nga Apeli dhe 3 niveli themelor i gjykatave) si dhe 4 bashkëpunëtorë profesional kryesisht të nivelit themelor të gjykatave dhe prokurorive. (3 nga gjykata dhe 1 nga prokuroria)

Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni Ferizaj

Më 5 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Ferizajit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Ferizajit për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave

të njeriut. Më tej u diskutua edhe për shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i pësojnë dhe shpesh edhe humbje të parevokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 1 mbrojtës i viktimave, 5 zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale, 2 avokatë si dhe 5 zyrtarë policor.



Trajnim: Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Më 06 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Implikimet praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale dhe gjyqtarëve nga Divizioni Civil për trajtimin e kontesteve që rrjedhin nga veprimtaria afariste e shoqërive tregtare në mënyrë meritore dhe në përputhje me standardet dhe dispozitat ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet sa i përket qëllimit kryesor të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe fushëveprimi i tij. Vëmendje e veçantë i është kushtuar mënyrave të themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare dhe pasojat juridike që krijojnë ato, mënyrës së organizimit, struktura e kapitalit, të drejtat dhe

detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë.

Gjatë trajnimit u diskutua edhe për përjashtimin e aksionarit nga shoqëria, për kompetencën e gjykatës, përkatësisht ndërhyrja e gjykatës në menaxhimin e Shoqërive Tregtare, detyrimi për besnikëri, konflikt i interesit dhe paditë për ortakëri dhe korporata.

Gjyqtarët pjesëmarrës në trajnim patën rastin e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe veçanërisht nga Gjykata e Apelit të cilat shërbyen si bazë e mirë për diskutime të përbashkëta dhe ofrimin e perspektivave të secilit prej tyre në çështjet e caktuara ligjore.

Përfitues të trajnimit ishin 12 gjyqtarë të Gjykatës Komerciale.



Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni Prishtinë

Më 6 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Prishtinës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Prishtinës për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtëpërdrejtë të të drejtave të njeriut. Më tej u diskutua edhe për shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i

pësojnë dhe shpesh edhe humbje të parevokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 21 pjesëmarrës. Prej tyre 2 prokuror, 1 avokat, 9 zyrtarë nga Qendra për punë sociale, 6 zyrtarë policor, 1 sekretar nga Oda e Avokatëve si dhe 2 mbrojtës të viktimave.



Trajnim: Provat në procedurën penale

Më 12-13 Prill 2023 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Provat në procedurën penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të bazës ligjore për sigurimin dhe përdorimin e provave në procedurën penale përmes të cilave mund të mbështetet vendimi gjyqësor.

Në ditën e parë të trajnimit u diskutua për faktet, provat, mjetet e provës, sigurimi dhe marrja e provës në procedurën paraprake, veçantia e provave të siguruara me anë të masave të fshehta, provat të cilat mund të sigurohen nga me anë të kontrollit si dhe për rastet kur proceduralisht shfrytëzohet mundësia hetuese e veçantë.

Në ditën e dytë u diskutua për fuqinë e provës

dhe besueshmërinë e saj në procedurë si dhe për veçantitë e sigurimit të provës relevante nga personi i dëmtuar, dëshmitarët e mbrojtur, anonim e posaçërisht dëshmitari bashkëpunues. Pjesëmarrësit patën mundësinë e pyetjeve dhe komenteve për të gjitha çështjet ligjore që u diskutuan gjatë këtij trajnimi. Po ashtu edhe të studimit të një rasti praktik për të cilin ofruan pikëpamjet e tyre për provat të cilat vërtetojnë pretendimet e organit akuzues për veprën penale përkatëse, pastaj për mënyrën e sigurimit të provës, për llojin e provës dhe detaje tjera rreth rastit konkret.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 20 gjyqtarë dhe 7 prokurorë të cilët ishin kryesisht të nivelit themelor



Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje pronësore

Më 12 Shkurt 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në formë të tryezës është realizuar trajnimi “Trajnimi për praktikën gjyqësore në çështje pronësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte identifikimi i praktikës jo unike në çështjet pronësore në gjykatat e instancave më të ulëta dhe adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore në çështjet pronësore.

Gjatë këtij trajnimi i cili u realizua në formë të tryezës u trajtuan çështjet më thelbësore në kuadër të drejtës pronësore, sfidat dhe vështirësitë e praktikës gjyqësore në çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët, fitimin derivativ dhe origjinerë të drejtës së pronësisë, mbrojtjen gjyqësore të drejtës së pronësisë, të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore dhe mbrojtja e servituteve sendore si dhe për posedimin dhe mbrojtjen e posedimit. Për të gjitha çështjet e trajtuara u përdoren

shembuj nga praktika gjyqësore duke pas në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rasteve përkatëse. Përmes këtyre shembujve është nxitur diskutimi interaktiv dhe analitik duke rezultuar me pikëpamjet teorike, doktrinare, perspektiva ligjore si dhe praktika gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshme për rastet përkatëse.

Si rezultat i kësaj tryeze priten konkluzionet përfundimtare të cilat do të shërbejnë për gjithë gjyqtarët që vendosin rastet në çështje pronësore si mekanizëm lehtësues në zbatimin unik të dispozitave të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 18 gjyqtarë, prej tyre 4 nga DHPGJS dhe 14 tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Program i Specializuar i trajnimit-Hartimi i akteve akuzuese nga Prokuroria Speciale

Më 13 Prill 2023, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane/OPDAT, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar Trajnimi -Hartimi i akteve akuzuese nga Prokuroria Speciale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive në fushën e përpilimit më të mirë të akteve akuzuese të PRSK-së, me theks në përshkrimin e saktë të veprës penale dhe përmbledhjen e fakteve si dhe në arsyetimin e drejtë për përmirësimin e cilësisë së akteve akuzuese në të ardhmen.

Gjatë këtij trajnimi u elaboruan parimet kryesore lidhur me draftimin e aktakuzës me theks te akuzat me krim të organizuar si dhe te format e akteve tjera në procedurën paraprake.

Në vazhdim u diskutua edhe për identifikimin e aseteve për sekuestrim dhe aplikimi i masave për sigurimin e pasurisë si dhe për kontrollin e akuzave në fazën e hershme dhe mundësinë për përmirësim para fillimit për shqyrtim gjyqësor.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve praktike përmes të cilave prokurorët patën rastin të draftojnë aktakuzën bazuar në rastin hipotetik ndërsa gjyqtarët ta kontrollojnë aktakuzën dhe të japin sygjerimet e tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 prokuror, 9 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, dhe 3 nga niveli themelor i Prokurorive si dhe 5 gjyqtarë nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë.



Trajnim: Kontestet e punës lidhur me statusin e nëpunësve civil sipas Ligjit për zyrtarët publik



Me 18-19 prill 2023, është realizuar trajnimi me temë: “Kontestet e punës lidhur me statusin e nëpunësve civil sipas Ligjit për zyrtarët publik”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me vlerësimin e kërkesave të nëpunësve civil, si në procedurën administrative ashtu edhe në procedurën gjyqësore si dhe gjykimi i drejtë dhe në kohë të arsyeshme lidhur me këto raste.

Që në fillim u potencua se zgjidhja e këtyre rasteve sot paraqet sfidë të madhe për sistemin gjyqësorë meqenëse për një afat të caktuar Gjykata Kushtetuese e ka ndaluar aplikimin e disa dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, prandaj me fillimin e aplikimit edhe të këtyre dispozitave ligjore trajtimi është vlerësuar si i domosdoshëm dhe me dobi.

Për dy ditë me radhë u trajtuan ëështje nga E drejta e nëpunësve civil dhe dallimet në mes tyre; Kategoritë e nëpunësve që gjykohen në procedurë kontestimore; Kategoritë e nëpunësve që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ si dhe Shqyrtimi i praktikës gjyqësore të deritanishme lidhur me vendimet gjyqësore mbi paditë për njohjen e të drejtës së nëpunësve publik.

Në këtë trajnim gjithashtu u trajtua natyra e kontesteve nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për Zyrtarët Publik veçmas: natyra juridike e kontesteve të punës, të cilat rrjedhin nga Ligji për Zyrtarët Publik, legjislacioni në fuqi tek këto konteste, fusha e zbatimit dhe llojet e kontratave

të punës (akt emërimeve) sipas LZP, shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës sipas LZP, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës ku paditës janë shërbyesit civil, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, dhe procedurat brendshme të cilat duhet ti shfrytëzohen shërbyesit civil, para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, përfshirë këtu edhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave të punës për shërbyesit civil, kompetencën, afatet, mjetet juridike etj.

Gjithashtu u shtjellua edhe respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, më saktësisht çështja e shterimit të mjeteve të brendshme juridike për të fituar të drejtën e kërimit të mbrojtjes gjyqësore, kompetencat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, si dhe pasojat juridike të mos respektimit të afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi tek këto konteste.

Në këtë trajnimi u përdoren metodat e: shpjegimit teorik, prezantimi i shembujve praktikë mbi parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës së marrëdhënies së punës lidhur me nëpunësit civil dhe zyrtarëve publik sipas legjislacionit në fuqi, si dhe diskutime rreth mënyrave si të nxjerrën vendime të bazuara në merita për çështjet aktuale, si të trajtojnë gjyqtarët ankesat në shkallë të ndryshme dhe si të i vendosin rastet në bazë të ligjshmërisë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 21 gjyqtarë nga departamenti për çështje administrative, departamenti i përgjithshëm, përkatësisht të divizionit civil nga të gjitha Gjykatat e Kosovës.

Program i Specializuar i Trajnimit-Pastrimi i parave dhe hetimi financiar

Më 18-20 Prill 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Pastrimi i parave dhe hetimi financiar - Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të prokurorëve në hetimin dhe grumbullimin e provave sa më suksesshëm dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave në mënyrë meritore nga ana e gjyqtarëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet sa i përket koncepteve themelore të legjislacionit kombëtarë dhe ndërkombëtarë të pastrimit të parave, e më pas edhe në elementet dhe fazat e pastrimit, hetimet financiare, kompetencat dhe bashkëpunimi me Njësinë e Inteligjencës Financiare

Me rastin e këtij trajnimi vëmendje e veçantë i është kushtuar praktikës gjyqësore e cila edhe më tej ka sfida dhe dilema në drejtim të identifikimit të elementeve të veprës penale që ndërlihet me pastrimin e parave dhe kualifikimin e saktë juridik të kësaj vepre

penale. Sfida të theksuara u evidentuan edhe në bashkëpunimin e brendshëm dhe ndërkombëtar dhe veçanërisht në mes organeve të ndjekjes së Republikës së Kosovës dhe organeve të ndjekjes së vendeve të Bashkimit Evropian dhe po ashtu vendeve që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përfshirjes së institucioneve tjera të cilat duhet të japin kontributin proaktiv në zbulimin, ndjekjen dhe dënimin e kryesve, me theks te NJIF, Dogana dhe Administrata Tatimore dhe si dhe institucionet financiare sikurse bankat, subjektet financiare jo banka dhe zyrat e këmbimit valutor, nëpërmjet kanaleve të transferimit të parave, pagesave apo kredisë.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e studimit të rasteve dhe diskutimeve në grup të cilat ndihmuan në gjetjen e zgjidhjeve më të mira ligjore si në sferën e hetimeve ashtu edhe në dënimin e kryesve për veprat përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë, 4 prokurorë, 8 zyrtarë policor dhe 2 zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës Financiare.



Trajnim: Vlerësimi i rrezikshmërisë në rastet e dhunës në familje

Më 18 prill 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me OPDAT është realizuar trajnimi për regjionin e Ferizajit dhe të Gjilanit me temë “Vlerësimi i rrezikshmërisë në rastet e Dhunës në Familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor lidhur me procedurat dhe mjetet për vlerësimin e rrezikut në rastet e dhunës në familje në mënyrë që kryesit e dhunës të mbahen përgjegjës dhe viktimat të gëzojnë mbrojtjen e duhur nga institucionet përkatëse.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet e hollësishme sa i përket kushteve të caktimit të paraburgimit, trajtimit të viktimave, komunikimit ndër institucional, mbrojtjes së viktimave, për faktorët lehtësues dhe rëndues si dhe për indikatorët e rrezikut në rastet e dhunës

në familje. Vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive dhe sfidave të praktikës gjyqësore të cilat u diskutuan nga ana e mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor përmes të cilave ofruan zgjidhjet më të mira ligjore.

Në trajnim vend të konsiderueshëm iu kushtua edhe perspektivës së SHBA-ve përmes ofrimit të shembujve nga praktika.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 2 prokurorë, 8 Zyrtar policor dhe 2 nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

Trajnim: Praktika e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëminë civile

Më 25 Prill 2023, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëminë civile”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastet e kërkesave në lëminë civile dhe administrative si dhe për marrëdhëniet midis gjykatave kushtetuese dhe atyre të rregullta dhe midis gjykatave kushtetuese dhe atyre të larta.

Trajnimi në fillim u përqendrua në ofrimin e informacioneve përkritazi me natyrën e lëndëve civile që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese, bazën kushtetuese dhe ligjore, qasjen e Gjykatës Kushtetuese në raste të natyrës civile si dhe referimet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjatë trajnimit është diskutuar edhe për kontestet pronësore, familjare apo trashëgimore, me të drejtat kushtetuese procedurale siç janë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; e drejta për mjet efektiv juridik; e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Fokus i diskutimit të trajnimit ishte tek kërkesat që paraqitën në Gjykatë Kushtetuese, në bazë të nenit 31- E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe neni 46 -Mbrojtja e Pronës, pasi që shumica e kërkesave nga lëmia civile në Gjykatën Kushtetuese, kanë të bëjnë me këto dy nene - të cilat në shumicën e rasteve paraqitën të ndërlidhura.

Një diskutim i rëndësishëm është zhvilluar gjithashtu lidhur me kontrollin kushtetues incidental, i cili mbështetet në nenin 113.8 të Kushtetutës.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ.

Përfitues në këtë trajnim ishin 10 gjyqtarë, prej tyre 2 nga Gjykatat Themelore, 5 nga Gjykata e Apelit, 3 nga Gjykata Supreme (2 prej tyre nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme)



Trajnim: Vërejtja policore, procedura dhe shabllonet-trajtimi i rasteve nga policia

Më 27 prill 2023, në bashkëpunim me EULEX në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Vërejtja policore, procedura dhe shabllonet, trajtimi i rasteve nga policia”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte elaborimi i hollësishëm i dispozitave lidhur me zbatimin e procedurës së paralajmërimit policor, si dhe sfidat e zbatimit të këtyre procedurave në polici dhe prokurori.

Gjatë trajnimit është diskutuar për sfidat e zbatimit të këtyre procedurave në polici dhe prokurori dhe hapat që duhet ndërmarrë për mënjanimin e tyre. Vëmendje e veçantë i është kushtuar vërejtjes policore si masë të diversitetit që e cakton zyrtari policor me lejen e prokurorit të shtetit për të mitur, si dhe mënyrës se si policia mban evidencën e vërejtjeve policore të shqiptuara, që nuk kanë

karakter të evidencës sikur tek të miturit e dënuar, dhe nuk mund të përdoret në çfarëdo mënyre që do ta dëmtonte të miturin.

Pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes rasteve praktike të identifikojnë praktikatat më të mira të cilat kanë rezultuar si rezultat i bashkëpunimit dhe komunikimit më të mirë të policisë dhe prokurorisë gjatë gjithë fazave të procedurës.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të kësaj tryeze ishin 1 gjyqtaë, 1 zyrtarë i lartë për bashkëpunim profesional si dhe 8 zyrtarë policor.



Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional-Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale



Më 24-26 prill 2023, në bashkëpunim me SAEK janë realizuar 3 trajnime nga Moduli Bazik –aspekti penal material për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor për Grupin e I-të me temat: “1. Zbatimi i ligjit më të favorshëm- Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë, 2. Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit si dhe 3. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, pastaj për veprat penale, elementet,

mënyra e kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale. Në vazhdim është diskutuar edhe për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë së vogël dhe përgjegjësia penale.

Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zërthejnë dispozitat ligjore.

Për tematikën e parë kanë marrë pjesë 17 pjesëmarrës, prej tyre 5 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 zyrtar ligjor nga gjykatat, 9 bashkëpunëtorë profesional, 1 udhëheqës i sektorit administrativ dhe 1 referent nga prokuroritë.

Për tematikën e dytë këtë trajnim kanë marrë pjesë 16 pjesëmarrës, prej tyre 4 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 zyrtarë ligjor nga gjykatat, 9 bashkëpunëtorë profesional, 1 udhëheqës i sektorit administrativ dhe 1 referent nga prokuroritë.

Për tematikën e tretë kanë marrë pjesë 18 pjesëmarrës prej tyre 6 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 zyrtarë ligjor dhe 1 zyrtar ekzekutiv nga gjykatat, 9 bashkëpunëtorë profesional, 1 referent nga prokuroritë.

Trajnim: E drejta e trashëgimisë dhe e drejta familjare

Më 27-28 prill 2023, në bashkëpunim me UNDP janë realizuar 2 trajnime nga Moduli Bazik –aspekti civil- material për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor për Grupin e I me temat: “1. E drejta e trashëgimisë dhe 2. E drejta familjare”

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave lidhur me kornizën ligjore sa i përket trashëgimisë dhe nga e drejta familjare dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga e drejta trashëgimore u diskutua për objektin e trashëgimisë, trashëgimia në bazë të ligjit dhe radhët e trashëgimisë. Në vijim për trashëgiminë në bazë të testamentit, llojet e testamentit, pjesa e domosdoshme dhe cenimi i saj si dhe për procedurën për shqyrtimin e saj.

Në kuadër të sesioneve nga e drejta familjare u diskutua për procedurat e zgjidhjes së martesës, fazat e procedurës së shkurorëzimit, mënyrat e vendosjes në procedurën e shkurorëzimit, besimi i fëmijëve dhe mënyra e rregullimit të kontaktit me prindin tjetër, alimentacioni, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet

martesore, format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimi, kujdestaria, statusi i fëmijëve dhe mbrojtja e tyre në rast të ndryshimit të statusit të tyre si dhe për procedurën gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që për çështjet që u diskutuan për dy ditë me radhë ti elaborojnë edhe përmes rasteve të shumta studimore dhe të gjejnë zgjidhjet e duhura ligjore për secilin rast.

Për trajnimin me fokus çështjet trashëgimore kanë marrë pjesë 23 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 17 bashkëpunëtorë profesional, 5 zyrtar ligjor si dhe 1 asistent administrativ. Nga Gjykata Supreme 3, nga Gjykata e Apelit 8 si dhe nga Gjykatat Themelore 12 .

Edhe për trajnimin me fokus në çështjet familjare kanë marrë pjesë 23 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 17 bashkëpunëtorë profesional, 5 zyrtar ligjor si dhe 1 asistent administrativ. Nga Gjykata Supreme 3, nga Gjykata e Apelit 8 si dhe nga Gjykatat Themelore 12 .



Aktivitetet për trajnues-profesionet e lira

Trajnim i Trajnuesve për Ndërmjetësim – Sesioni V

Më 22 dhe 23 prill 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, ka vazhduar me sesionin e V-të të Trajnimit të Trajnuesve për Ndërmjetësim.

Ky sesion, shënon edhe fundin e sesioneve trajnuese për trajnues, me ç'rast shërbeu si një përmbledhje e të gjitha trajnimeve të mëparshme duke përfshirë të gjitha materialet dhe temat e trajtuara.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë rreth gjithë ciklit të trajnimeve, përfitimet dhe mësimet nga trajnimi, çështjet që




ende duhet përmirësuar, punët që i presin në të ardhmen që lidhen me ndërmjetësimin, si dhe vitin e tretë të projektit që pritet të vazhdojë nga shtatori 2023.

Pas trajnimit të trajnuesve, pjesëmarrësit të ndarë në tri (3) grupe, pritet të zhvillojnë edhe tre ditë trajnim të avancuar për ndërmjetësim, aktivitet i cili do i paraprijë ceremonisë së certifikimit të kandidatëve të suksesshëm.


Përfitues të trajnimit ishin 13 ndërmjetësues të përzgjedhur në programin e Trajnimit të Trajnuesve.



Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës Prill 2023





Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara Prill 2023



Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike Prill 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel: +383 38 200 18 660